



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:107449
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05841972

K.Dh.Sh. II.nr. 434/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Estetik”, sh.p.k, me nr. unik identifikues 811049007, me seli në Ferizaj, rr. “Rexhep Bislimi” p.n., kundër debitorit B.F., B.I, (DPH “Fontana”), me nr. unik identifikues 810345133, me adresë në rr. “Bahri Barku” p.n., në Mitrovicë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Safet Voca nga Mitrovica, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.2400/22 të datës 23.10.2023, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit B.F., B.I. me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2400/22 të datës 23.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar 2400/22 të datës 23.10.2023, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit B.F., B.I. me seli në Mitrovicë, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 565/22, i lejuar me datë 03.10.2022, nga Përmbartuesi

Privat Besnik H. Aliu dhe Urdhri Përmbarrimor P.nr. 565/22, i lejuar me datë 03.10.2022, nga Përmbarruesi Privat Besnik H. Aliu mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuara dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 2400/22 të datës 23.10.2023 dhe lënda të kthehet në rivendosje ose aktvendimi i ankimuar të ndryshohet.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Estetik”, sh.p.k., me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbarrim P.nr. 565/22 të datës 03.10.2022, me të cilin ka lejuar përmbarrimin, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturë nr.11/2021 e datës 20.05.2021, dhe Faturë nr.17/21 e datës 25.06.2021, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 16,348.70€, (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e katërdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë euro cent) me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi. Debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar Urdhrin për Lejimin e Përmbarrimit duke theksuar se dokumenti në bazë të cilit përmbarruesi privat ka lejuar urdhrin nuk e ka cilësinë e titullit përmbarrimor sepse i njëjti është dashur t’i dorëzohet debitorit së bashku me propozimin për përmbarrim gjegjësisht me urdhrin për lejimin e përmbarrimit dhe atë në origjinal e as në kopje të vërtetuar sipas ligjit. Ka shtuar se përmbarruesi privat me rastin e lëshimit të urdhrin nuk i ka vlerësuar drejt provat sepse debitori dhe kreditori nuk kanë pasur të lidhur një kontratë ligjërish

të obligueshme sipas të cilës do t'i përcaktonin të drejtat dhe detyrimet. Tutje ka theksuar se debitori në kohë dhe mënyrë të rregullt e ka përmbushur obligimin dhe këtë fakt e vërteton Pasqyra Financiare e lëshuar nga BKT, andaj nuk qëndron pretendimi i kreditorit se debitori ka borxh shumë prej 16,348.70€. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar dhe Urdhri Përmbarimor të shfuqizohet. Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se nuk ekziston asnjë nga kushtet për anulimin e urdhrit përmbarimor pasi që faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29 par.1.3 të LPP-së. Sa i përket pagesave për të cilat pretendon debitori se ka bërë pagesa, kreditori thekson se të njëjtat nuk janë llogaritur në propozimin për përmbarim. Me kërkesë që refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me arsyetim se në rastin konkret faturat, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu ka shtuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor nga përmbaruesi privat, përmbaruesit privat bazohet në dokument të besueshme, përkatësisht faturën nr. Faturë nr.11/2021 e datës 20.05.2021, dhe Faturë nr.17/21 e datës 25.06.2021, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përmbajnë të

gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, koha e përmbushjes së detyrimit, shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula dhe nënshkrimi i debitorit. Andaj faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuar. Po ashtu gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuar nga kreditori, të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, që në rastin konkret të njëjtat janë pranuar nga debitori.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore,

prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Kjo gjykatë vlerëson se faturat si dokumentë në sajë të cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, janë pranuar nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit dhe vulës së të njëjtit. Andaj, pranimi i së njëjtës nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga faturat andaj edhe konsiderohet si dokument i besueshëm.

Andaj, kjo Gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përbarimore, respektivisht është lejuar përbarimi i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Kështu, Gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përbarues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Dhoma e shkallës së dytë është e qëndrimit se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk II.nr. 434/24 me datë 20.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri